# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8293
E hënë, 4 maj 2026
Çmimi 0. 50 €


**Dita Botërore e Lirisë së Shtypit, AGK-ja: Gazetarët në Kosovë vazhdojnë të mbesin target i sulmeve** FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# MBI 10 MILIONË EURO PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT, FUSHATA ZGJEDHORE DHJETË DITË

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar planin e buxhetit për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 7 qershor, i cili kap vlerën 10,887,186.45 euro. Po ashtu, është vendosur që periudha zyrtare e fushatës zgjedhore të zgjasë 10 ditë. Njohësit e çështjeve politike e vlerësojnë të lodhshëm ciklin e shkurtër zgjedhor. Sociologu dhe analisti politik Artan Muhaxhiri thotë se mbajtja e shpeshtë e zgjedhjeve është shndërruar në praktikë rraskapitëse. Ndërkaq qytetarët kanë theksuar se as zgjedhjet e ardhshme parlamentare nuk do ta ndryshojnë situatën në skenën politike dhe institucionale



## STRADNER: REZOLUTA AMERIKANE PËR KOSOVËN NË NATO ËSHTË 'SINJAL I FORTË POLITIK'

F. 5



## NDAHET NGA JETA BABAI I VEPRIMTARIT BARDHYL MAHMUTI, VARRIMI BËHET SOT NË TETOVË

F. 6

## AKTUALE



### TRUMPI THOTË SE DO TA SHQYRTOJË PROPOZIMIN E FUNDIT TË IRANIT

F. 2

### DASH: BLLOKIMI I VAZHDUESHËM POLITIK DËMTON BESIMIN NË INSTITUCIONET E KOSOVËS

F. 5

### KURTI NË ARMENI PËR SAMITIN E KOMUNITETIT POLITIK EVROPIAN

F. 5

## EKONOMI



### DHTIK: KRIZA POLITIKE DHE SHKUARJA NË ZGJEDHJE PO GODASIN EKONOMINË

F. 7

### VENDET E PASIGURTA TË PUNËS

F. 8

## SPORT



### FFK-ja SHËNON 10-VJETORIN E ANËTARËSIMIT NË UEFA E FIFA ME AKTIVITETE FESTIVE NË HAJVALI

F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel:+389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax:+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# TRUMPI THOTË SE DO TA SHQYRTOJË PROPOZIMIN E FUNDIT TË IRANIT

**Uashington, 3 maj** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se së shpejti do të vlerësojë një propozim të ri për paqe të ofruar nga Teherani, por shtoi se “nuk mund ta imagjinojë” që ai të jetë i pranueshëm dhe aludoi për mundësinë e rifillimit të sulmeve ajrore ndaj Iranit. “Shumë shpejt do ta shqyrtoj planin që Irani sapo na ka dërguar, por nuk mund ta imagjinoj se do të jetë i pranueshëm, pasi ata ende nuk kanë paguar çmim mjaftueshëm të madh për atë që i kanë bërë njerëzimit dhe botës gjatë 47 vjetëve të fundit”, shkroi ai në Truth Social më 2 maj.

Ai më herët u tha gazetarëve se ishte informuar për konceptin bazë të ofertës së Teheranit, por po priste që bashkëpunëtorët e tij ta njoftonin për hollësitë, duke aluduar për mundësinë e rifillimit të sulmeve nëse Irani “sillet keq”. “Ata [bashkëpunëtorët e ShBA-së] më treguan për konceptin e marrëveshjes. Tani do të më japin formulimin e saktë”, tha ai teksa u nis me aeroplan drejt Miamit nga Florida, ku kalon shumicën e fundjavave.

I pyetur nëse mund t’i rifillojë sulmet ndaj Iranit, Trumpi tha: “Nuk dua ta them këtë. Nuk mund t’ia them këtë një gazetari. Nëse ata sillen keq, nëse bëjnë diçka të gabuar, do të shohim tani. Por, është një gjë që mund të ndodhë”.

Disa orë para kësaj deklarate të Trumpit, një zyrtar i lartë iranian dha hollësi për një propozim paqeje të dorëzuar nga Teherani, duke thënë se ai përbëhej nga 14 pika, përfshirë shumë prej tyre që tashmë janë refuzuar nga udhëheqësi amerikan.

Propozimi i Teheranit përfshin kushte për të cilat është raportuar më herët, që parashikojnë rihapjen e Ngushticës së Hormuzit dhe përfundimin e bllokadës amerikane ndaj porteve iraniane, ndërsa bisedimet për programin bërthamor të Iranit, sipas propozimit, do të liheshin për më vonë.

Kushtet e tjera iraniane përfshijnë tërheqjen e forcave amerikane nga zonat përreth Iranit, lirimin e aseteve iraniane të ngrira, pagesën e kompensimeve për dëmet e luftës, heqjen eventuale të sanksioneve ndaj Teheranit dhe përfundimin e të gjitha luftimeve, përfshirë edhe në Liban.

Trumpi, i cili më 1 maj tha se “nuk ishte i kënaqur” me propozimin më të fundit të Teheranit, ka këmbëngulur vazhdimisht se Irani nuk mund të ketë kurrë armë bërthamore dhe duhet të heqë dorë nga rezervat e tij të uraniumit, tashmë të pasuruar.

Ai ka deklaruar se bllokada amerikane ndaj porteve iraniane nuk do të përfundojë derisa të finalizohet një marrëveshje paqeje.

Teksa Trumpi shpesh ka deklaruar se Irani po kërkon me ngulm një marrëveshje paqeje, ai ka thënë se mund ta rifillojë fushatën ajrore kundër objektivave iraniane - përfshirë edhe infrastrukturën civile - nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje.



Trumpi, në një fjalim më 1 maj, tha se ShBA-ja nuk do ta përfundojë përballjen me Iranin herët vetëm që “problemi të rishfaqet pas tre vjetësh”. “Në këtë moment nuk jam i kënaqur me atë që po ofrojnë”, u tha Trumpi gazetarëve, duke shtuar se udhëheqja iraniane është duke u përballur me “mosmarrëveshje të mëdha” të brendshme.

Bllokimi i Ngushticës së Hormuzit nga Irani - një rrugë ujore kyçe përmes së cilës kalonin rreth 20 për qind e furnizimeve botërore me naftë dhe gaz natyror para luftës - ka rritur çmimet e energjisë në nivel global, duke krijuar rrezik për recesion në shumë vende dhe duke ushtruar presion politik mbi Trumpin.

Në prill, ShBA-ja vendosi bllokadën e saj ndaj anijeve që vinin nga portet iraniane, teksa njëkohësisht u pajtua për një armëpushim që hyri në fuqi më 8 prill, duke ndërprerë sulmet që ShBA-ja dhe Izraeli nisën ndaj Iranit në fund të shkurtit.

# IZRAELI MIRATON MARRËVESHJEN PËR BLERJEN E AEROPLANËVE LUFTARAKË NGA SHBA-ja

Jerusalem, 3 maj - Izraeli tha të dielën se ka miratuar një marrëveshje multimiliardëshe për blerjen e dy grupeve të aeroplanëve luftarakë nga Shtetet e Bashkuara. Kjo blerje përfshin një grup aeroplanësh shumëfunksionalë F-35 nga kompania Lockheed Martin dhe një tjetër me aeroplanë luftarakë F-15IA nga Boeing, njoftoi Ministria e Mbrojtjes e Izraelit.

Ky plan synon të “sigurojë epërsinë ajrore të Izraelit për dekadat e ardhshme”, tha ministri i Mbrojtjes, Israel Katz, përmes një deklarate. “Blerjet e F-35 dhe F-15IA janë qendrore për planin ‘Mburoja e Izraelit’, i cili është hartuar për t’u dhënë Forcave të Mbrojtjes së Izraelit një epërsi cilësore dhe të qëndrueshme. Misioni ynë është i qartë: të sigurojmë që ushtria të ketë mjetet, aftësitë dhe forcën për të vepruar kudo, në çdo kohë”, shtoi Katz.

F-35, një projekt i përbashkët mes Shteteve të Bashkuara dhe disa aleatëve, është një nga aeroplanët ushtarakë më të avancuar në botë. Izraeli tashmë ka disa dhjetëra aeroplanë të tillë.

Forca ajrore e Izraelit luajti një rol kyç në luftën në Gaza, duke kryer një nga fushatat më intensive të bombardimeve ajrore në historinë moderne.

Mijëra sulme shënjestruan ato që Izraeli tha se ishin caqe të Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - përfshirë



tunele, qendra komanduese, vendndodhje të raketahedhësve, por edhe zona të mëdha të këtij territori u shkatërruan, përfshirë shtëpi, spitale dhe shkolla.

Izraeli, po ashtu, me forcën e saj ajrore ka zhvilluar dy luftëra kundër Iranit në më pak se një vit, gjatë të cilave fuqia e saj ajrore është përdorur për sulme me rreze të gjatë veprimi thellë brenda territorit iranian.

Zyrtarët izraelitë i kanë përshkruar këto sulme si precize që kishin për qëllim dobësimin e aftësive strategjike të Iranit, teksa zyrtarët iranianë kanë raportuar për sulme ajrore në qytetet kyçe dhe zona industriale.

Izraeli së fundi miratoi buxhetin për vitin 2026, i cili përfshin një rritje prej miliarda dollarësh për shpenzimet në fushën e mbrojtjes.

Shpenzimet ushtarake të Izraelit janë rritur vazhdimisht që nga fillimi i luftës në Gaza, që u nxit nga sulmi i Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor 2023.

Përveç luftës së fundit disajavore me Iranin, e zhvilluar së bashku me ShBA-në, Izraeli vazhdon të përballet edhe me lëvizjen islamiste Hezbollah, e mbështetur nga Irani, në Libanin jugor.

## OPEC+ njofton për shtimin e prodhimit të naftës pas rritjes së çmimeve

**Riadi, 3 maj** - Shtatë nga prodhuesit më të mëdhenj të naftës në botë kanë njoftuar se do ta rrisin prodhimin e tyre “për të mbështetur stabilitetin e tregut të naftës”, vetëm pak ditë pas një rritjeje të ndjeshme të çmimeve, mes frikës në treg se transporti përmes Ngushticës së Hormuzit nuk do të rifillojë së shpejti.

Arabia Saudite, Rusia, Iraku, Kuvajti, Kazakistani, Algjeria dhe Omani vendosën gjatë një takimi virtual më 3 maj për ta rritur prodhimin me 188 000 fuçi në ditë në muajin qershor.

Vendimi vjen pasi çmimet e naftës arritën nivelin më të lartë që kur Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës më 2022, duke shkuar në 126 dollarë për fuçi më 29 prill, teksa “The Wall Street Journal” raportoi se presidenti amerikan, Donald Trump, u kishte thënë bashkëpunëtorëve të përgatiteshin për një bllokadë “të zgjatur” të porteve iraniane.

“Vendet do të vazhdojnë të monitorojnë nga afër dhe të vlerësojnë kushtet e tregut, në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për ta mbështetur stabilitetin e tregut”, u tha në një deklaratë të Organizatës të Shteteve Eksportuese të Naftës (OPEC+).

Megjithatë, edhe pse ky hap mund të sjellë një lehtësim të pjesshëm, ai nuk i ndryshon shkaqet kyçe të çmimeve aktuale.

Bllokada e ShBA-së po pengon Iranin të transportojë naftë drejt Kinës, duke shtuar presionet mbi çmimet e larta, që u rritën për shkak të bllokadës iraniane në Ngushticën e Hormuzit, duke ndaluar edhe shtetet e tjera në Gjirin Persik që të dërgojnë furnizime me naftë te klientët në mbarë botën.



Bllokada amerikane ndaj porteve iraniane nisi më 13 prill, pasi bisedimet në Islamabad mes ShBA-së dhe Iranit dështuan të prodhonin një marrëveshje për përfundimin e luftës.

EPOKA E RE
Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# STRADNER: REZOLUTA AMERIKANE PËR KOSOVËN NË NATO ËSHTË 'SINJAL I FORTË POLITIK'



PRISHTINË, 3 MAJ - Kosova mori një shtytje politike në synimin e saj për t'u bërë pjesë e NATO-s, aleancës ushtarake që ndërhyri më 1999 për t'i dhënë fund luftës, pasi tre kongresistë amerikanë paraqitën këtë javë një rezolutë në mbështetje të aspiratës së saj të kamotshme.
Rezoluta, e paraqitur më 30 prill me mbështetje dypartiake nga kongresistët Keith Self, Ritchie Torres dhe Mike Lawler, nxiti gjithashtu reagim të menjëhershëm nga Serbia, e cila rregullisht e lufton anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.
Për Ivan Stradnerin nga Fondacioni për Mbrojtjen e Demokracisë në Uashington (FDD), rezoluta është "sinjal i fortë politik, pasi e afron Kosovën më pranë NATO-s në kuptimin strategjik". "Në letër, Kosova mund të mos jetë shumë më afër anëtarësimit, duke qenë se katër aleatë të NATO-s ende nuk e njohin, por ky është hap në drejtimin e duhur në një kohë kur gjendja e sigurisë në rajon po përkeqësohet", thotë Stradner për Radion Evropa e Lirë.
Kosova nuk ka bërë ende kërkesë formale për t'u anëtarësuar në NATO, pasi përballet me pengesa të mëdha, siç është mungesa e njohjes së saj nga katër vendet anëtare: Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.
Ajo, gjithashtu, është aktualisht duke e shndërruar Forcën e Sigurisë në ushtri të plotë, që pritet të zgjasë deri më 2028.
Për më tepër, Kosova nuk është as pjesë e programit të NATO-s, Partneriteti për Paqe, i cili shërben si rrugë për çdo vend që dëshiron të bëhet anëtar i aleancës ushtarake.
Pranimi i një anëtari të ri kërkon njëzëshmëri brenda aleancës, prandaj edhe rezoluta e paraqitur nga kongresistët i kërkon Uashingtonit t'i nxisë këto katër vende anëtare ta njohin shtetin më të ri në Evropë.
Stradner vlerëson se nismat në Kongres, siç është kjo rezolutë, mund të mos jenë në gjendje t'i detyrojnë aleatët e NATO-s t'i ndryshojnë qëndrimet e tyre, por ato formësojnë mjedisin politik duke treguar se Uashingtoni e sheh Ballkanin si një çështje të papërfunduar strategjike dhe pret më shumë unitet brenda aleancës. "Ato gjithashtu dërgojnë sinjal të qartë në debatin e brendshëm amerikan se nuk është koha për të kufizuar apo tërhequr angazhimet ushtarake amerikane nga aleanca në Ballkan pavarësisht prej zërave të herëpashershëm në këtë drejtim. Një prani e qëndrueshme ushtarake e ShBA-së në Evropë mbetet thelbësore për parandalimin dhe stabilitetin afatgjatë", thekson ajo.
Ka pasur zëra muajt e fundit se ShBA-ja mund t'i tërheqë trupat nga NATO-ja, përfshirë nga misioni paqeruajtës i saj në Kosovë, KFOR. Por, Pentagoni i ka thënë më herët Radios Evropa e Lirë se nuk kishte ndonjë njoftim për ndryshim të zhvendosjes së forcave.
Rreth 590 forca amerikane shërbejnë në Kosovë si pjesë e misionit paqeruajtës të NATO-s. Dhe, sipas Stradnerit, kjo rezolutë gjithashtu "dërgon mesazh të qartë se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të investojnë në rolin dhe kohezionin e NATO-s".

## Rezoluta pasqyron "tensionet rajonale"

Stradner beson se paraqitja e rezolutës amerikane në këtë kohë pasqyron "si tensionet e vazhdueshme rajonale, ashtu edhe një garë më të gjerë gjeopolitike, ku zonat gri po shihen gjithnjë e më shumë si dobësi".
Tensionet në rajon janë shtuar kohën e fundit, me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, që pretendon pa ofruar prova se vendet fqinje "po përgatiten" për sulm ndaj saj.
Për ta forcuar narrativin e tij, Vuçiqi paralajmëroi javë më parë investime të reja në ushtri dhe rritje të mëtejshme të kapaciteteve mbrojtëse, duke theksuar se Serbia duhet të jetë e përgatitur për çdo zhvillim në një "situatë komplekse" sigurie, të shkaktuar nga aktivitetet e Prishtinës, Tiranës dhe Zagrebit.
Ai po i referohej një deklarate të përbashkët për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes mes Kosovës dhe dy anëtareve të NATO-s, Shqipërisë dhe Kroacisë.
Që të tri vendet kanë thënë vazhdimisht se deklarata trepalëshe mes tyre nuk është e drejtuar kundër askujt dhe se synimi është zhvillimi i mbrojtjes.
Kosova, në anën tjetër, vitet e fundit e ka akuzuar Serbinë për agresion për shkak të stërvitjeve ushtarake pranë kufirit të saj.
Stradner thotë se Ballkani Perëndimor ka treguar tashmë se sa shpejt mund të përshkallëzohen tensionet, duke i përmendur incidentet gjatë protestave të vitit 2023 në veriun e banuar me shumicë serbe, ku u lënduan mbi 90 paqeruajtës të NATO-s në Kosovë. Këto incidente, sipas saj, nënvizojnë se aleanca "nuk po përballet me rreziqe abstrakte, por me pika reale tensioni". "Derisa po përballet me vështirësi në luftën e tij në Ukrainë, Putini po kërkon mënyra të reja për ta sfiduar Perëndimin, dhe hapja e një konflikti të ri në Ballkan është gjithmonë në 'menynë ushtarake' të tij, me ndihmën e Vuçiqit. Pikërisht për këtë arsye NATO ka interes për stabilitet në rajon", thekson Stradner.
Ajo beson se mësimi që shumë politikëbërës e nxjerrin nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia, i cili nisi më 2022 dhe po vazhdon, është i "drejtpërdrejtë". "Vendet jashtë NATO-s, si Ukraina, mbeten të ekspozuara, ndërsa anëtarësimi në NATO ofron një nivel parandalimi që aktorë si Putini hezitojnë ta sfidojnë drejtpërdrejt", thotë ajo.
Kjo vlen për Kosovën, një vend që gëzoi lirinë falë ndërhyrjes së NATO-s më 1999 për ta zmbrapsur regjimin e atëhershëm serb, pasi zyrtarët e saj e kanë përsëritur vazhdimisht se vendi do të jetë më i sigurt duke qenë pjesë e aleancës.

## Kundërshtimi i Serbisë, i "parashikueshëm"

Serbia e lufton publikisht pavarësinë e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare dhe, sipas Stradnerit, reagimi i Vuçiqit ndaj rezolutës amerikane nuk është i papritur. Në një marrëveshje të vitit 2023 në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, Serbia ishte zotuar se nuk do ta bllokonte anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Megjithatë, ajo nuk i është përmbajtur zotimit tri vjet pas dhe e ka vazhduar lobimin kundër fqinjit. "Kundërshtimi i Vuçiqit ndaj kësaj rezolute është i parashikueshëm. Ai ka pak interes të mirëpresë një prani më të fortë të NATO-s, por pjesëmarrja e Serbisë në ushtrime të rastësishme të NATO-s nuk duhet të ngatërrohet me një rreshtim të plotë, sidomos duke pasur parasysh bashkëpunimin e saj paralel ushtarak me Rusinë dhe Kinën", thekson Stradner.
Serbia është ushtarakisht neutrale, por është pjesë e programit të NATO-s Partneriteti për Paqe dhe bashkëpunon me aleancën në këtë frymë. Megjithatë, njëkohësisht ajo kryen vazhdimisht stërvitje ushtarake me Kinën dhe nuk i është bashkuar Perëndimit në vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë për pushtimin e Ukrainës. "Serbia është duke i zgjeruar kapacitetet e veta ushtarake me mbështetjen e partnerëve të jashtëm, ndërsa Vuçiq po vazhdon të balancojë mes Brukselit, Moskës dhe Pekinit në një mënyrë që ngre shqetësime të arsyeshme për drejtimin afatgjatë të Serbisë", nënvizon Stradner.
Ajo vë në pah se, pavarësisht se qeveria serbe përfiton nga fondet e BE-së, retorika dhe pozicionimi i Vuçiqit "shpesh pasqyrojnë tema të lidhura me Vladimir Putinin, veçanërisht në kontekstin e ndikimit rajonal dhe narrativëve si një 'botë serbe' më e gjerë".
"Presionet e brendshme gjithashtu kanë rëndësi: ndërsa protestat dhe tensionet politike brenda Serbisë rriten, ekziston një model i përsëritur ku Vuçiqi priret të përshkallëzojë për ta depërshkallëzuar situatën në rajon", përfundon ajo.



# MBI 10 MILIONË EURO PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT, FUSHATA ZGJEDHORE DHJETË DITË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar planin e buxhetit për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 7 qershor i cili kap vlerën 10,887,186.45 euro. Po ashtu, është vendosur që periudha zyrtare e fushatës zgjedhore të zgjasë 10 ditë. Njohësit e çështjeve politike e vlerësojnë të lodhshëm ciklin e shkurtër zgjedhor. Sociologu dhe analisti politik Artan Muhaxhiri thotë se
mbajtja e shpeshtë e zgjedhjeve është shndërruar në praktikë rraskapitëse. Ndërkaq qytetarët kanë theksuar se as zgjedhjet e ardhshme parlamentare nuk do ta ndryshojnë situatën në skenën politike dhe institucionale

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MAJ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar planin e buxhetit për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 7 qershor. Gjatë mbledhjes, KQZ-ja ka miratuar planin e buxhetit për organizimin e zgjedhjeve, i cili kap vlerën 10,887,186.45 euro. Po ashtu, është vendosur që periudha zyrtare e fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit të zgjasë 10 ditë e 7 orë, duke filluar më 28 maj dhe duke përfunduar më 7 qershor në orën 06:59.

KQZ-ja, po ashtu, mori vendim për caktimin e afateve dhe miratoi planin e aktiviteteve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, i cili përfshin, ndër të tjera: deklarimin e partive politike për pjesëmarrje/mospjesëmarrje në zgjedhje; deklarimin e partive politike për formimin e koalicioneve; aplikimin për certifikimin e subjekteve politike; dorëzimin e listave të kandidatëve dhe verifikimin e tyre; periudhën e fushatës zgjedhore; caktimin e qendrave të votimit, përfshirë përfaqësitë diplomatike; regjistrimin e votuesve brenda dhe jashtë Kosovës; periudhën e votimit përmes postës dhe në përfaqësi diplomatike; certifikimin e listës së votuesve; akreditimin e vëzhguesve dhe mediave; si dhe emërimin e anëtarëve të 38 Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve dhe këshillave të vendvotimeve.

Deklarimi i partive politike për pjesëmarrje ose mospjesëmarrje në zgjedhje dhe për formimin e koalicioneve bëhet nga 1 maj deri më 7 maj.

Aplikimi për certifikim të subjekteve politike (përfshirë koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur) zhvillohet nga 2 maj deri më 10 maj, ndërsa dorëzimi i listave të kandidatëve për deputetë bëhet nga 2 maj deri më 12 maj.

KQZ-ja vendos për certifikimin e subjekteve politike deri më 10 maj, ndërsa për kandidatët deri më 15 maj.

Shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim hidhet më 16 maj.

Sa iu përket votuesve dhe organizimit teknik: Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës bëhet nga 6 maj deri më 17 maj, ndërsa votimi përmes postës zhvillohet nga 25 maj deri më 6 qershor. Votimi në përfaqësi diplomatike do të mbahet më 6 qershor, nga ora 07:00 deri 19:00.

Brenda vendit periudha për kundërshtimin dhe korrigjimin e listës së votuesve zgjat nga 6 maj deri më 18 maj.

Po ashtu, KQZ-ja ka paraparë afate për regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta, akreditimin e vëzhguesve dhe emërimin e komisioneve zgjedhore komunale dhe këshillave të vendvotimeve gjatë muajit maj.

Dita e zgjedhjeve është caktuar më 7 qershor, me orar votimi nga 07:00 deri 19:00.

## Efekti i kundërt i zgjedhjeve

Njohësit e çështjeve shoqërore e vlerësojnë të lodhshëm ciklin e shkurtër zgjedhor.

Sociologu dhe analisti politik Artan Muhaxhiri thotë se demokracia është sistem qeverisës që ka për qëllim fuqizimin e qytetarëve. Por, sipas tij, mbajtja e shpeshtë e zgjedhjeve shndërrohet në praktikë rraskapitëse, me efekt të kundërt: humbjen e besimit në votë dhe gërryerjen e substancës politike. "Rituali demokratik bëhet pikërisht vetë ai që e rrënon frymën dhe kuptimin e demokracisë. Harxhohet energjia politike dhe ndodh një demobilizim i pjesëmarrësve në proceset e radhës", thotë Muhaxhiri për Radion Evropa e Lirë (REL).

Vitin e kaluar, përveç dy palë zgjedhjeve parlamentare, në shumicën e komunave të Kosovës u mbajtën edhe dy raunde të zgjedhjeve lokale.

Vebi Mujku nga Instituti për Zhvillimin e Politikave Sociale (IZHPS) kujton se, për shumicën e qytetarëve, do të jetë hera e pestë që votojnë brenda 16 muajsh. "Të dalësh pesë herë [në votime] për një periudhë kaq të shkurtër kohore është jashtëzakonisht e rëndë për secilin qytetar, qoftë në aspektin ekonomik për

shtetin, qoftë në aspektin social të qëndrueshmërisë për qytetarë", thotë Mujku për REL-in.
Qytetarë në Prishtinë, me të cilët bisedoi REL-i, i shohin të lodhshme votimet e shpeshta. "Jo që na kanë lodhur, por na kanë lodhur tepër. Po përsëriten gjërat e njëjta. Emrat e njëjtë do të promovohen sërish, nuk ka ndonjë ndryshim, programe të reja nuk ka", thotë Gazmend Zhuri.
Edona Selimi shpreh mendimin se as zgjedhjet e ardhshme parlamentare nuk do ta ndryshojnë situatën në skenën politike dhe institucionale. "Sigurisht që na ka lodhur ky cikël i ri i zgjedhjeve. Besoj që shumë pak prej popullatës ka për të dalë herën tjetër [në votime]", thotë ajo.
Për Ekrem Nezirin jo vetëm zgjedhjet e shpeshta janë të lodhshme, por edhe aktivitetet e subjekteve politike të zhvilluara brenda periudhës ndërmjet zgjedhjeve. "Nuk ka vetëm një fajtor. Të gjithë janë, dikush më pak, e dikush më shumë. Të gjithë duhet mbajtur përgjegjës", shprehet ai.

### Pasojat e tjera

Muhaxhiri e sheh situatën si jashtëzakonisht dëmtuese për Kosovën, sepse qytetarët, thotë ai, nisin ta perceptojnë të votuarit si "strukturalisht të kotë", pasi nuk shohin efekte konkrete në ecurinë e jetës institucionale. "Kësisoj, edhe aktorët që kanë potencial të kontribuojnë në mënyrë cilësore në jetën politike e humbin motivin dhe gradualisht tërhiqen, duke e degraduar edhe më shumë diskursin politik", thekson Muhaxhiri. "Më e rrezikshmja është ideja e normalizimit të mosfunksionimit demokratik, pasi kështu investohet në ndërtimin e kulturës fataliste, që e minon entuziazmin, vetëbesimin dhe sigurinë kolektive", thotë ai.
Muhaxhiri shton se, në këtë situatë, zbehet respekti ndaj sistemit dhe mund të dalin në pah forma jashtinstitucionale të veprimit. Gjithashtu, sipas tij, në mesin e qytetarëve shkaktohen polarizime të mëdha, pa ndonjë thellësi ideologjike, duke shkaktuar "stres social të përmasave të gjera", i cili ndikon në mënyrën në të cilën qytetarët e mendojnë dhe e përjetojnë raportin e tyre me shtetin.
Mujku thotë se në komunikimet që ka me disa fokus grupe, ka parë zhgënjim të qytetarëve me partitë politike. Sipas tij, shumë qytetarë nuk presin që zgjedhjet e reja do të prodhojnë zgjidhje për krizën politike dhe institucionale. "Shumë prej personave kanë reaguar duke thënë që nuk do të dalin [në votime], sidomos disa që kanë qenë fanatikë të subjekteve të caktuara politike", tregon Mujku, i cili parasheh se dalja e qytetarëve në votime në zgjedhjet e ardhshme do të jetë më e ulët se në ato të fundvitit.
Përsëritja e zgjedhjeve, pa rezultatin e stabilizimit të institucioneve, sipas sociologëve shkakton zhgënjime të thella dhe pasoja shumëdimensionale në shoqëri.
Ndër to është, sipas Muhaxhirit, është edhe "ankthi ekonomik", i cili i ka dy aspekte kryesore: pezullimin e planeve afatgjate jetësore në Kosovë dhe rritjen e nivelit të emigrimit. "Emigrimi transformohet në një akt të heshtur politik, si reagim protestues fundamental ndaj gjithë spektrit politik, ndërkohë që kjo i bën dinamikat elektorale më të pafuqishme", thotë ai.

# DASH: BLLOKIMI I VAZHDUESHËM POLITIK DËMTON BESIMIN NË INSTITUCIONET E KOSOVËS




PRISHTINË, 3 MAJ - Shtetet e Bashkuara të Amerikës po ndjekin nga afër zhvillimet e fundit në Kosovë, ndërsa shprehin shqetësim për vazhdimin e bllokadës politike në vend.
Një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit tha për Radion Evropa e Lirë se "bllokimi i vazhdueshëm politik dëmton besimin në institucionet e Kosovës". "Ne po i ndjekim nga afër zhvillimet. Do të donim t'i shihnim të gjitha grupet politike të bashkëpunojnë për interesat më të mira të popullit të Kosovës", tha zëdhënësi.
Kosova do të 'ibajë zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 7 qershor.
Ato u shpallën pasi Kuvendi u shpërnda automatikisht këtë javë për shkak të dështimit për ta zgjedhur presidentin e ri brenda afatit kushtetues.
Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, e akuzoi opozitën për bojkotim të qëllimshëm të seancave, ndërsa partitë opozitare e fajësuan pushtetin për mungesë bashkëpunimi dhe për tentim të përqendrimit të pushtetit në një dorë të vetme.
Legjislatura e dhjetë, e dalë nga zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit, zgjati më pak se tre muaj.
Ato zgjedhje u mbajtën pas një krize të zgjatur politike që nisi pas zgjedhjeve të rregullta të 9 shkurtit 2025, kur Kuvendi nuk arriti të konstituohej për muaj të tërë dhe përpjekjet për formimin e Qeverisë përfunduan pa sukses.
Analistët paralajmërojnë se Kosova rrezikon të përballet me një skenar të ngjashëm me atë të Bullgarisë, e cila në pesë vjetët e fundit ka kaluar nëpër shtatë cikle zgjedhjesh të njëpasnjëshme, pa arritur stabilitet institucional.
Ata shtojnë se kriza ndikon edhe në ritmin e vendimmarrjes shtetërore dhe sjell barrë të konsiderueshme financiare për buxhetin e shtetit.
Më 2 maj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftoi se ka nisur afati për partitë politike për t'u deklaruar për pjesëmarrje në zgjedhjet e 7 qershorit, si dhe për formimin e koalicioneve, i cili do të zgjasë deri më 7 maj.
Sipas planit të aktiviteteve të miratuar nga KQZ-ja, më 2 maj ka nisur edhe afati për certifikimin e partive të reja dhe dorëzimin e listave të kandidatëve për deputetë. Afati për partitë e reja përfundon më 10 maj, ndërsa për listat e kandidatëve më 12 maj.
Një ditë më parë, KQZ-ja miratoi edhe planin e aktiviteteve dhe buxhetin për zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të kushtojnë 10 milionë e 887 mijë euro.
Fushata zgjedhore do të zgjasë 10 ditë, nga 28 maji deri më 7 qershor në orën 07:00, kur hapen vendvotimet.
Votimi me postë do të zhvillohet nga 25 maji deri më 6 qershor, ndërsa një ditë para zgjedhjeve do të organizohet votimi në përfaqësitë diplomatike.
Regjistrimi për votim nga jashtë vendit do të bëhet nga 6 deri më 17 maj.
Në zgjedhjet e 28 dhjetorit, mbi 2 milionë qytetarë të Kosovës, brenda dhe jashtë vendit, kishin të drejtë vote - një shifër që pritet të mbetet e ngjashme edhe në zgjedhjet e ardhshme. Pjesëmarrja ishte rreth 45 për qind.

## Kurti në Armeni për samitin e Komunitetit Politik Evropian



Prishtinë, 3 maj - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar drejt Armenisë për të marrë pjesë në samitin e Komunitetit Politik Evropian, bëri me dije ekzekutivi i Kosovës. "Në Jerevan, kryeministri në detyrë Kurti do të marrë pjesë në samitin e Komunitetit Politik Evropian dhe pritet të ketë takime të nivelit të lartë me zyrtarë dhe liderë shtetesh pjesëmarrëse. Ai, po ashtu, do të jetë pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare Yerevan Dialogue", u tha në njoftim.
Samiti i tetë i Komunitetit Politik Evropian mbahet më 4 maj në Jerevan të Armenisë nën moton "Ndërtimi i së ardhmes: Uniteti dhe Stabiliteti i Evropës".
Ai pritet të mbledhë udhëheqës evropianë dhe krerët e organizatave ndërkombëtare "në një moment vendimtar për formësimin dhe forcimin e rrugës kolektive të Evropës". "Ai do të shërbejë si një forum gjithëpërfshirës për dialog të hapur, koordinim strategjik dhe reflektim të përbashkët mbi prioritetet e Evropës, duke nxitur bashkëpunim, mirëkuptim të ndërsjellë dhe iniciativa konkrete që mbështesin një kontinent më të qëndrueshëm dhe më të orientuar drejt së ardhme", thuhet në ueb-faqen e samitit, që do të mbahet në kryeqytetin armen.
Mikpritësi i samitit të sivjetshëm, kryeministri armen, Nikol Pashinian, në një mesazh drejtuar të ftuarve në këtë takim tha se në një kohë të transformimit të madh në Evropë, Komuniteti Politik Evropian ka dalë si një platformë unike dhe gjithëpërfshirëse për dialog. "Samiti i Jerevanit do të ndërtojë mbi këtë frymë, duke mbledhur udhëheqës dhe partnerë për të forcuar bashkëpunimin, rritur besimin dhe avancuar një vizion të përbashkët për një Evropë të sigurt, paqësore dhe të bashkuar", tha ai. Sipas Pashinianit, në samit do të diskutohen një sërë temash kyç, sikurse kërcënimet hibride, e deri tek energjia. "Armenia është e nderuar që është mikpritëse e këtij samiti të rëndësishëm dhe të luajë rol aktiv në formësimin e të ardhmes së Evropës", shkroi Pashinian. Në samit, Bashkimi Evropian do të përfaqësohet nga presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, së bashku me shefen e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen do të përfaqësojnë BE-në.
Para Armenisë, mikpritëse e samitit të Komunitetit Politik Evropian ishte Danimarka, takim në të cilin Kosova u përfaqësua nga tashmë ish-presidentja Vjosa Osmani.

# DITA BOTËRORE E LIRISË SË SHTYPIT, AGK-ja: GAZETARËT NË KOSOVË VAZHDOJNË TË MBESIN TARGET I SULMEVE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 MAJ - Në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, kur sërish theksohet zëshëm rëndësia e medias së lirë dhe të pavarur në shoqëri, gazetarët në Kosovë vazhdojnë të ballafaqohen me një numër sfidash gjatë kryerjes së punës së tyre. Kështu ka vlerësuar Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). Sipas AGK-së, kryesorja mbetet një fushatë e pandalshme nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe partisë politike në pushtet, Vetëvendosjes, në përpjekje për ta delegjitimuar punën e gazetarëve. "Gazetarët dhe mediat mbesin cak i sulmeve nëpërmjet fjalorit denigrues që ka për qëllim uljen e besimit të publikut në raportimin e tyre. AGK-ja i bën thirrje Qeverisë në detyrë, Vetëvendosjes dhe gjithë akterëve politikë që të respektojnë dhe të mos e pengojnë punën e gazetarëve, si faktor kyç në zhvillimin demokratik të vendit. AGK-ja shpreh shqetësim që shumica parlamentare, në një procedurë të shpejtë dhe të komprometuar, ka zgjedhur anëtarët e bordeve të RTK-së dhe KPM-së, që ka rezultuar, siç kemi paralajmëruar, në tendencë të hapur për kontrollimin politik dhe partiak të të dyja institucioneve", është thënë në reagimin e AGK-së.



AGK-ja ka theksuar se vëren përmirësimin në renditjen e Kosovës në Indeksin e Reporterëve Pa Kufij këtë vit, i cili ka ndodhur për shkak të vendimit meritor të Gjykatës Kushtetuese që e ka shpallur antikushtetues Ligjin për KPM-në, të miratuar në Kuvend nga Vetëvendosja. "Nëpërmjet këtij vendimi dhe të tjerëve, sistemi gjyqësor mbetet garantuesi më i rëndësishëm i lirisë së medias në Kosovë. Kjo reflektohet edhe në miratimin e Strategjisë së KGJK-së që do t'u japë prioritet rasteve të gazetarëve. AGK-ja bën thirrje për politika më të ashpra ndëshkimore në rastet kur gazetarët janë viktima të sulmeve. AGK-ja vazhdon të mbetet e përkushtuar për sigurinë e gazetarëve, duke i dokumentuar dhe denoncuar ato e duke punuar me organet e sigurisë e drejtësisë për zgjidhjen e rasteve. AGK-ja angazhohet për përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët dhe punonjësit medialë dhe i inkurajon ata që të paraqesin në Inspektoratin e Punës mosrespektimin e kontratave dhe të Ligjit të Punës në përgjithësi. Me punën e tyre të vazhdueshme, gazetarët dhe mediat në Kosovë vazhdojnë t'i shërbejnë interesit publik për informim dhe luajnë rol të pazëvendësueshëm në forcimin e demokracisë në Kosovë", është thënë, ndër të tjera, në reagimin e AGK-së.

# ARRESTOHEN DY PERSONA PËR MASHTRIM KOMPJUTERIK, SEKUESTROHEN MBI 48 MIJË EURO DHE DHJETË VETURA



PRISHTINË, 3 MAJ - Prokuroria Themelore në Prishtinë, në koordinim me Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, ka njoftuar se është realizuar bastisje në pesë lokacione të ndryshme në kuadër të hetimeve lidhur me dyshimin për kryerjen e veprës penale "Mashtrimi kompjuterik", sipas nenit 277/K, sipas të Ligjit nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.
Bastisjet janë zhvilluar në dy lokacione në fshatin Samadraxhë, komuna e Suharekës, si dhe në tri lokacione në qytetin e Prishtinës.
Gjatë këtij operacioni janë sekuestruar 48.350 euro para të gatshme, dhjetë vetura me vlerë të përgjithshme rreth një milion euro, si dhe pajisje elektronike, që pritet të shërbejnë si prova materiale në këtë procedurë penale.
Në kuadër të veprimeve hetimore të ndërmarra në këtë çështje, me urdhër të Prokurorit të Shtetit janë arrestuar dy persona dhe ata janë ndaluar për 48 orë, pasi dyshohen për kryerjen e veprës penale "Mashtrimi kompjuterik", sipas nenit 277/K, të Ligjit nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.
Prokurori i çështjes, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për zbardhjen e plotë të rastit.
Brenda afatit ligjor Prokurori i Shtetit do të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarve.
Prokuroria Themelore në Prishtinë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë personave që kryejnë vepra penale.

# ARRESTOHEN DY PERSONA PËR MASHTRIM KOMPJUTERIK, SEKUESTROHEN MBI 48 MIJË EURO DHE DHJETË VETURA

PRISHTINË, 3 MAJ - Veprimtari Bardhyl Mahmuti ka njoftuar të dielën për ndarjen nga jeta të babait të tij, Beqir Berisha, i cili ndërroi jetë sot, më 3 maj 2026. Sipas njoftimit të familjes, ceremonia e varrimit do të mbahet të hënën, më 4 maj, në orën 13:30, në varrezat e Tetovës.
Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" ka shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të atdhetarit Beqir Berisha. "Me pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të Beqir Berishës, atdhetarit e intelektualit të shquar nga Tetova. Në emër të Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", i shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta familjes së tij si dhe të gjithë shqiptarëve, për këtë humbje të madhe. Beqir Berisha do të kujtohet me respekt si njeri i qëndresës, i dijes dhe i dinjitetit; si filozof, gazetar, autor dhe i burgosur politik, që jetën e tij e lidhi me lirinë dhe me idealin kombëtar shqiptar", thuhet në telegramin ngushëllues të kësaj qendre.
Më tej theksohet se me veprën e tij letrare dhe studimore, me qëndresën e tij morale dhe me përkushtimin ndaj fjalës së lirë, Beqir Berisha la gjurmë të pashlyeshme në kulturën shqiptare. Librat e tij dhe artikujt e shumtë nëpër gazeta, nga aktualiteti kulturor e politik e deri te kujtesa dokumentare e refleksionet filozofike, mbeten dëshmi e një jete të kaluar në shërbim të dijes, identitetit dhe dinjitetit kombëtar e njerëzor. "Ai ishte gjithashtu mbështetës i madh i Qendrës 'Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur' dhe i kauzës sonë për ngadhënjimin e drejtësisë për gjenocidin e kryer nga forcat serbe kundër shqiptarëve të Kosovës. Edhe në ditët e vështira të përballjes me sëmundjen, Beqir Berisha nuk iu nda librit dhe kërkimit të së vërtetës. Libri i fundit që lexoi ishte romani i të birit të tij, Bardhyl Mahmuti, "Revolta e Syzifit", një vepër kushtuar krimit të gjenocidit në Poklek të Vjetër. Ky fakt e bën edhe më të veçantë kujtimin për të. Në këto çaste të rënda dhimbjeje, ndajmë pikëllimin me familjen e tij, me të afërmit, miqtë dhe bashkëveprimtarët e tij si dhe të gjithë shqiptarët që humbën një zë të rëndësishëm të kulturës dhe mendimit shqiptar. Lavdi jetës dhe veprës së atdhetarit Beqir Berisha! Qoftë i përjetshëm kujtimi për jetën dhe veprën e tij", thuhet në telegramin ngushëllues të Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur".



# VENDET E PASIGURTA TË PUNËS



**Prishtinë, 3 maj** - Sipas të dhënave të Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat deri më 24 prill, tetë punëtorë kanë humbur jetën gjatë këtij viti. Por, që nga kjo datë, autoritetet raportuan për vdekjen e dy punëtorëve të tjerë dhe pas rasteve me fatalitet në prill, autoritetet kryen inspektime në nivel vendi. Megjithatë, nga Inspektorati Qendror i Punës i thanë Radios Evropa e Lirë (REL) se jo të gjitha rastet me fatalitet ishin punëtorë. “Prej tyre, një vdekje në vendpunishte nuk ka qenë punëtor, por ka qenë mbledhës i hekurave, dhe një rast ka të bëjë me sulm kardiak gjatë orarit të punës”, thotë Kaltrina Cakolli, zëdhënëse në këtë inspektorat.

## Si i gjeti 1 Maji punëtorët në Kosovë?

Për kreun e Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, vdekja e punëtorëve në vendet e tyre të punës është “jashtëzakonisht shqetësuese”.
Sindikatat e Punëtorëve vazhdimisht janë ankuar për kushtet e punës dhe për shkeljen e të drejtave të tyre në punë. Sipas Azemit, gjendja e punëtorëve të sektorit privat nuk ka vëmendjen “as nga pronarët e kompanive dhe as nga qeveria e shtetit”.
Ai thotë se problematike janë edhe pagat për punëtorë. “Me këto paga që i kemi nuk po mund të mbijetojmë”, thotë ai, teksa shton se gjendja “më e rëndë” është te punëtorët e kompanive që kryejnë shërbime për institucionet shtetërore. “Këtu na kanë sanksionuar me paga. Paramendojeni që edhe sot, kur po flasim, ka punëtorë që marrin 239 euro pagë”.
Për sektorin publik, përmes një vendimi të Qeverisë së Kosovës vitin e kaluar, është rritur paga minimale nga 350 euro, në 425 euro në janar, ndërkaq në korrik parashihet të bëhet 500 euro për të gjithë punëtorët me orar të plotë.
Nga Inspektorati Qendror i Punës nuk treguan se si e vlerësojnë situatën e punëtorëve e me çfarë shkeljesh përballen ata. Në një përgjigje me shkrim, zëdhënësja Kaltrina Cakolli u shpreh se kanë pranuar 391 ankesa, por nuk dha detaje.
Por, sipas një raporti për vitin e kaluar ky inspektorat pranoi 1.660 ankesa, nga të cilat shumica dërmuese - 1.233 - ishin nga punëtorët e sektorit privat, 418 nga ai publik dhe nëntë nga sektori publiko-privat.
Nga inspektimet që thuhet se janë bërë vitin e shkuar, në raport janë evidentuar 1.946 punëtorë pa kontrata dhe 6.611 raste të shkeljeve të drejtave të tjera të punëtorëve. Në mesin e shkeljeve janë identifikuar 2.091 raste që lidhen me pagën, 1.918 me orarin e punës, 1.802 me marrëdhënie pune e 782 raste që lidhen me pushimet.

## Evidentohen shkelje gjatë inspektimeve në nivel vendi

Teksa sindikata dhe IQP-ja kanë vlerësime të ndryshme lidhur me numrin e punëtorëve që humbën jetën gjatë këtij viti në vendet e punës, vdekja e një 59-vjeçari në Ferizaj më 13 prill, nxiti ministrin, tashmë në detyrë të Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, që të urdhëronte një inspektim 15-ditor në sektorët me rrezikshmëri të lartë – përfshirë edhe atë të ndërtimit.
Por, teksa ky aksion po zhvillohej, u raportua edhe për raste të tjera me fatalitet në vendpunishte.
Hoti, gjatë një adresimi në Kuvend më 24 prill, tha se aksidentet me fatalitet në vendin e punës po ndodhin “për shkak të neglizhencës dhe mos plotësimit të kritereve të sigurisë janë të papranueshme”. Megjithatë, Hoti theksoi se aksioni inspektues nuk ishte kundër bizneseve, “por mbi çdo biznes, çdo fitim është jeta e qytetarit”.
Në raportet çdo 48 orë që ka publikuar Inspektorati Qendror i Punës, që nga 16 prilli kur nisi aksioni e deri më 29 prill, në nivel vendi janë kryer 294 inspektime. Nga to, puna është ndaluar në 123 raste derisa vërejtje për kushtet e punës janë dhënë në 108 raste të tjera.
Zëdhënësja e këtij institucioni, Kaltrina Cakolli, tha se gjatë inspektimeve është hasur në mungesë të kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës. “Mosvendosja e skelarisë, rrethojave të brendshme, [gjendja teknike] e pajisjeve të punës [duke përfshirë edhe vinçat], mungesa e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë të vendeve të punës, trajnimet dhe kontrollet mjekësore”, janë disa nga gjetjet e inspektimit që përmend ajo.
Por, Azemi nga Sindikata e Punëtorëve të Sektorit Privat, tha se ky aksion nuk do të ketë asnjë efekt në përmirësimin e kushteve. “Nuk ka ndonjë ndryshim ose nuk sheh kompani që punëtorët janë të pajisur me mjetet mbrojtëse ashtu siç e kërkon Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë”, thotë ai, duke shtuar se “për 10 ditë mund të verifikohen rreth 400 kompani dhe kompani që duhet të kontrollohen janë mbi 40.000”.
Sipas Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, punëdhënësit janë të obliguar të sigurojnë kushte të sigurta pune, përfshirë trajnimin e punëtorëve dhe përdorimin e duhur të pajisjeve.
Azemi thotë se inspektimet e vendeve të punës duhet të jenë punë e përditshme e inspektorëve, numri i të cilëve vlerëson se është i pamjaftueshëm. “Kjo është një lloj fushate…e kanë bërë sa për të thënë se po bëjmë diçka”, thotë Azemi. “I vetmi element që do të kishte ndikuar në rënien e [vdekjeve të] këtyre punëtorëve do të ishte që institucionet, pronarët e kompanive, Inspektorati dhe sindikata të kenë një program të përbashkët në edukimin dhe trajnimin edhe të pronarëve të kompanisë, por në veçanti të punëtorëve”, shton ai.
Viti i kaluar ishte po ashtu i kobshëm për punëtorët, pasi sipas sindikatës që drejton Azemi, vdiqën 32 punëtorë. “Viti 2025 ka qenë viti me numrin më të madh të vdekjeve të punëtorëve në vendet e tyre të punës”, thotë ai.
Por, shifër më e vogël paraqitet në raportin e Inspektoratit Qendror të Punës, përkatësisht ky inspektorat tha se vitin e kaluar u shënuan 19 aksidente me fatalitet.
Megjithatë, derisa të dhënat për vdekjet në vendet e punës ndryshojnë, për punëtorët e lënduar konsiderohet edhe më i vështirë evidentimi i rasteve.
Inspektorati i Punës, në raportin vjetor për vitin e shkuar, ka identifikuar 602 raste të lëndimeve, 33 për qind e së cilave në ndërtimtari.
Azemi, në anën tjetër, thotë se në bazë të një hulumtimi që kanë bërë rreth katër vjet më parë, mesatarisht 1 mijë e 700 punëtorë janë lënduar brenda një viti. “[Numrin e punëtorëve të lënduar në vendet e punës] nuk mund ta nxjerrim asnjëherë saktë sepse në shumicën e rasteve, punëtorët që pësojnë lëndime nuk tregojnë, pasi frikësohen nga pronarët e kompanive”, shprehet ai.

# DhTIK: Kriza politike dhe shkuarja në zgjedhje po godasin ekonominë

**Prishtinë, 3 maj** - Kriza politike në vend dhe shkuarja në zgjedhje të reja po krijojnë pasiguri serioze për ekonominë e Kosovës, duke rrezikuar stabilitetin e bizneseve dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Kështu u tha në takimin e organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë me komunitetin e biznesit.
Kryetari i Bordit, Skender Krasniqi dhe kryetari i Kuvendit të DHTIK-së, Hamdi Malushaj, theksuan se përkundër sfidave të shumta me të cilat u përball Kosova që nga fillimi i vitit të kaluar, Dhoma ka qenë vazhdimisht aktive në adresimin e sukseseve dhe problemeve të sektorit privat.
Nga ana tjetër, drejtori ekzekutiv, Kushtrim Ahmeti, theksoi se zgjedhjet e shpeshta po prodhojnë kosto të drejtpërdrejta për ekonominë. “Çdo proces i ri zgjedhor nënkupton muaj të tërë të humbur për vendimmarrje dhe projekte zhvillimore. Kjo po u kushton bizneseve me vonesa, humbje financiare dhe pasiguri të mëdha për të ardhmen dhe investimet. Ekonomia nuk mund të presë pafundësisht cikle politike - ajo ka nevojë për stabilitet të menjëhershëm”, tha ai.



Përfaqësues të bizneseve shpalosën sfidat me të cilat po përballen, duke përfshirë rritjen e kostove të prodhimit, importin e madh, mungesën e mbështetjes institucionale dhe vonesat e shumta në vendimmarrje. Ata nënvizuan rolin e DHTIK-së, duke lobuar për zgjidhje konkrete, propozuar politika lehtësuese, si dhe duke ndërmjetësuar komunikimin ndërmjet institucioneve dhe sektorit privat.
Në takim u potencua edhe rëndësia e krijimit të një stabiliteti politik si parakusht për zhvillim ekonomik, si dhe nevoja për vendime të shpejta dhe të qëndrueshme.
Të pranishmit u dakorduan që të intensifikohet komunikimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë, me qëllim të adresimit më efektiv të sfidave dhe mbrojtjes së interesave të komunitetit të biznesit në këtë periudhë sfiduese.




# Sport




## Artet marciale: 'Luftëtarët' e Kosovës vijnë nga Greqia me tri medalje historike

**Prishtinë, 3 maj** - Federata e Arteve Mikse Marciale e Kosovës ka shënuar arritje të rëndësishme në debutimin e saj në Kampionatin Evropian të MMA-së, të organizuar nga Global Association of Mixed Martial Arts në Loutraki.

Garuesi Ermal Berisha i siguroi Kosovës medaljen e argjendtë në kategorinë -70 kg, pas një rrugëtimi mbresëlënës drejt finales me dy fitore të rëndësishme. Megjithatë, ai nuk arriti të garojë në finalen e madhe për shkak të një prerjeje serioze në vetull, me vendim të stafit mjekësor.

Sukses tjetër për ekipin kosovar solli Ylli Rexhaj, i cili fitoi medaljen e bronztë në kategorinë -80 kg, ndërsa në konkurrencën e të rinjve, Muhamed Kashtanjeva u shpërblye me medalje të bronztë në kategorinë -58 kg, transmeton Klankosova.tv.

Ky rezultat përbën një moment historik për MMA-në kosovare, duke dëshmuar potencialin dhe përkushtimin e sportistëve në arenën ndërkombëtare.

Komiteti Olimpik i Kosovës përgëzoi garuesit, trajnerët dhe federatën për këtë sukses të rëndësishëm.




## FFK-ja shënon 10-vjetorin e anëtarësimit në UEFA e FIFA me aktivitete festive në Hajvali

**Prishtinë, 3 maj** - Federata e Futbollit e Kosovës ka shënuar 10-vjetorin e anëtarësimit në UEFA dhe FIFA me një sërë aktivitetesh të organizuara në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, duke përkujtuar një nga momentet më të rëndësishme në historinë e futbollit dhe shtetit të Kosovës.

Në kuadër të kësaj dite festive u zhvilluan ndeshje simbolike me pjesëmarrjen e ekipeve të Policisë së Kosovës, Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke reflektuar unitetin dhe bashkëpunimin institucional në mbështetje të sportit. Në finalen e turneut, Forca e Sigurisë së Kosovës triumfoi ndaj Policisë së Kosovës, ndërsa trofeun fitues e dorëzoi presidenti i FFK-së, Agim Ademi.

Një moment i veçantë i aktivitetit ishte ndeshja e Kombëtares së Amputuarve, e cila dëshmoi forcën e shpirtit, vullnetin dhe përkushtimin ndaj futbollit përtej çdo sfide. Paralelisht, gjatë gjithë ditës u zhvillua festivali "Grassroots", ku fëmijë nga shtatë regjione të Kosovës sollën energji, buzëqeshje dhe entuziazëm, duke dëshmuar se e ardhmja e futbollit kosovar është e sigurt.

Në fjalën e tij, presidenti Agim Ademi vlerësoi rrugëtimin e gjatë dhe të vështirë drejt anëtarësimit në UEFA dhe FIFA, duke shprehur mirënjohje për të gjithë ata që kontribuuan në këtë arritje historike dhe duke theksuar rëndësinë e unitetit për zhvillimin e mëtejmë të futbollit në vend.



Aktivitetet u përmbyllën me ndeshjen ndërmjet veteranëve të Kosovës dhe Shqipërisë. Pas një përballjeje të baraspeshuar, fituesi u përcaktua përmes penalltive, ku më të saktë u treguan veteranët e Kosovës. Në përfundim të ndeshjes, trofeu simbolik iu dorëzua kapitenit të veteranëve të Kosovës, Hysni Gjinovci, nga presidenti Agim Ademi.

Kjo ndeshje kishte një domethënie të veçantë, pasi në përbërje të veteranëve të Kosovës ishin edhe futbollistë të gjeneratës së sakrificës, të cilët gjatë viteve të okupimit zhvilluan aktivitetin futbollistik jashtë stadiumeve, duke ruajtur gjallë frymën e lojës dhe duke kontribuar në rrugëtimin drejt ndërkombëtarizimit të futbollit të Kosovës.

Më 3 maj 2016, në Kongresin e Budapestit, u mbyll një epokë izolimi dhe u hapën dyert e familjes evropiane. Sakrifica e gjatë u shndërrua në krenari, ndërsa shpresa mori formë konkrete në arenën ndërkombëtare të futbollit. Vetëm dhjetë ditë më vonë, më 13 maj 2016, në Kongresin e FIFA-s në Mexico City, Kosova u pranua edhe në familjen botërore të futbollit. Në kongresin e parë të presidentit aktual Gianni Infantino, Kosovës iu dha mirëseardhje zyrtare, duke vulosur një moment historik të pakthyeshëm.

Që atëherë, rrugëtimi ynë ka qenë i jashtëzakonshëm. Nga pozita e 190-të në renditjen e FIFA-s, sot Kosova renditet e 78-ta, një dëshmi e qartë se kur talentit i jepet mundësia, ai lulëzon dhe shndërrohet në forcë kombëtare.

## Fitorja minimale e Llapit e largon Ballkanin nga titulli



**Prishtinë, 3 maj** - Llapi ka shënuar fitore 0:1 ndaj Ballkanit në ndeshjen e vlefshme për javën e 32-të në Superligën e Kosovës në futboll. Golin e vetëm e realizoi Arbnor Ramadani. Me këtë fitore, skuadra e Tahir Batatinës shkon në kuotën e 39 pikëve në pozitën e 8, kurse Ballkani mbetet në kuotën e 55 pikëve në pozitën e dytë dhe tani shumë larg titullit kampion, apo saktësisht tetë pikë prapa lideres Dritës.

Ndërkaq Gjilani dhe Ferizaj kanë ndarë pikët në një barazim 1-1, në një ndeshje të tensionuar ku vëmendja kryesore shkoi te vendimet e gjyqtarëve, në krye me Burim Jahmurataj.

Takimi u karakterizua nga një numër i madh kartonësh - plot 13 të verdhë, ndërsa vendimet kontroverse nuk munguan.

Fillimisht u anulua një gol i Haxhimisës për Gjilanin, ndërsa më pas u akordua një penallti për Ferizajn në minutat shtesë (90+13), vendim që u diskutua shumë nga kampi vendas.

Dramë e vërtetë u zhvillua në fundin e ndeshjes. Në minutën e 82-të, Senad Jarovic kaloi Gjilanin në epërsi, kurse në minutën e 102-të, Erion Sadriu humbi një penallti që mund të vuloste ndeshjen.

Megjithatë, vetëm pak sekonda më vonë, në vazhdimin e aksionit, Bekima Cloud arriti të shënojë dhe t'i sigurojë një pikë ekipit të tij, që nuk kishte vlerë pasi Llapi dhe Drenica fituan në udhëtim.

Pas këtij barazimi, Gjilani shkon në kuotën e 45 pikëve, duke mbetur shtatë pikë larg vendit të tretë që mbahet nga Malisheva dhe që siguron dalje në garat evropiane.

## Zidane refuzon Real Madridin

**Prishtinë, 3 maj** - Trajneri francez Zinedine Zidane thuhet se ka refuzuar mundësinë për një rikthim në stolin e Real Madrid, pasi i kishte dhënë tashmë fjalën Federatës Franceze të Futbollit.

Zidane vazhdon të jetë pa angazhim në ndonjë klub që prej largimit të tij nga "Los Blancos", në një kohë kur klubi madrilen po përballet me një periudhë të vështirë në aspektin sportive, transmeton Klankosova.tv.

Skuadra është pranë përfundimit të një tjetër sezoni pa trofe, duke shtuar presionin mbi drejtuesit dhe stafin teknik.

Sipas raportimit të "Diario AS", drejtuesit e Real Madridit kishin kontaktuar drejtpërdrejt Zidanen që në muajin dhjetor, duke i kërkuar që të rikthehej për të zëvendësuar Xabi Alonson. "Real Madridi kishte kontakt direkt me Zinedine Zidane në muajin dhjetor, duke i kërkuar ta zëvendësonte Xabi Alonson", shkruan mediumi spanjoll. Megjithatë, përgjigjja e teknikut francez ka qenë negative, ai ka bërë të ditur se tashmë ishte vonë për një rikthim, pasi kishte mbyllur marrëveshjen me Federatën Franceze. Ai pritet ta



marrë drejtimin e Franca pas përfundimit të Kupa e Botës 2026, ku do të pasojë aktualin Didier Deschamps.

F2.2/BNJ/KP/RR

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 06/03/3237
Dt. 30.04.2026
Shtojcë
Prishtinë-Pristina

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A**

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe 12, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e datës 28.04.2026 me numër të protokollit 02/01/243 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

**KONKURS PUBLIK**

**Për plotësimin e vendit të punës**

| | |
|---|---|
| Titulli i Vendit të punës: | Kontrollor Intern Qendror |
| Nr. i kërkuar: | Një (1) pozitë, Selia Qendrore në KRM "Pastrimi" SH.A |
| Numri i Referencës: | **KP/RR**/SQ/10-2026 |
| Koeficienti/Paga mujore: | Niveli X |
| Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: | Me kohë të pa caktuar |
| Periudha Provuese: | 3 muaj |

1. **Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1.1 Inspekton dhe kontrollon shërbimin e amvisërisë, bizneseve dhe kontratave të veçanta, duke evidencuar dhe raportuar çdo keqpërdorim apo parregullsi eventuale që dëmton interesin dhe imazhin e kompanisë;
1.2 Bashkëpunon me Udhëheqësin e njësisë rreth kontrollës interne dhe me stafin e kompanisë lidhur me planet konkrete të veprimit dhe punës;
1.3 Mban ditarin personal të punës së inspektimeve në të cilin evidencon, inspektimet, vërejtjet dhe veprimet e ndërmarra dhe të bën përpunimin analitik të të dhënave, për të cilat raporton tek Udhëheqësi në baza javore;
1.4 Siguron se të gjitha raportet dhe të dhënat e paraqitura nga fushëveprimi i inspektimit të tij, janë të sakta dhe në përputhje me gjendjen reale, të cilat në rast kontesti do t'i argumentoj;
1.5 Nën instruksionet e udhëheqësit të kontrolles interne, kryen punët dhe detyrat operative të kontrolles në teren, lidhur me kryerjen e shërbimeve ndaj konsumatorëve, kualitetin dhe rrjedhjen e tyre;
1.6 Inspekton terrenin e kamionëve gjatë transportit në linja grumbulluese;
1.7 Në bashkëpunim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, inspekton dhe raporton keqpërdorimet eventuale të së drejtës në pushim mjekësor dhe çfarëdo keqpërdorimi tjetër;
1.8 Inspekton respektimin e orarit të punës nga të punësuarit në teren dhe në raste të kërkesës edhe në administratë;
1.9 Të inspektoj dhe verifikoj numrin e zbrazjeve dhe saktësinë e tyre;
1.10 Të intervenoj menjëherë në rastet kur t'i jepet urdhri konkret për veprim;
1.11 Kryen punë tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit drejtpërdrejtë;
1.12 Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë së Kontrollës Interne Operative.

**2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:**

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

**3. Kërkesat e përgjithshme formale**

- ✓ Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare apo shkollim i mesëm
- ✓ Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 vit përvojë pune

**4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit**

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

**5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre**

| | |
|---|---|
| Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati | ✓ |
| Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës) | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme) | ✓ |
| Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme) | ✓ |
| Dokument identifikimi e Republikës së Kosovës | ✓ |
| Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj | ✓ |

**6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:**

**6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:**

* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.
* në recepcionin e kompanisë.

**6.2 Dorëzimi i aplikacionit:**

* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

**7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;**

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 04/05/2026 deri me datën 19/05/2026.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

**6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:**

**6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:**

* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.
* në recepcionin e kompanisë.

**6.2 Dorëzimi i aplikacionit:**

* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

**7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;**

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 04/05/2026 deri me datën 19/05/2026.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

**8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.**

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ Testit me shkrim: deri në 60 pikë
- ✓ CV-ja e kandidatit: deri në 10 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 30 pikë.

**9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.**

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

**10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:**

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

F2.2/BNJ/KP/RR

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 06/03/3737 Shtojcë
Dt. 30.04.2026
Prishtinë-Pristina

**REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A. D.**

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, posebno člana 8, na osnovu Uredbe br. 07/2024 o radnom odnosu u CRM "Čišćenje" a.d., konkretno člana 11. stav 1.2 i 12, na osnovu Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" A.D, na osnovu Odluke od 28.04.2026. godine sa brojem protokola 02/01/243 izvršnog direktora RPO-a "PASTRIMI" A.D, objavite ovo:

**JAVNI KONKURS**

**Za popunjavanje radnog mesta**

Naziv posla: Interni kontrolor u Centar
Br. Potreban: Jedno (1) radno mesto, Sedište u RPO "PASTRIMI" A.D
Referentni broj: **KP / RR** / SK / 10-2026
kvota / Mesečna plata: Nivo X
Trajanje ugovora o radu: Na neodređeno vreme
Probni period: 3 meseca

**1. Dužnosti i odgovornosti:**

1.1 Proverava i kontroliše usluge domaćinstava, preduzeća i posebnih ugovora, naglašavajući i izveštavajući o mogućim zloupotrebama ili nepravilnostima koje štete interesu i imidžu kompanije;
1.2 Sarađuje sa šefom Jedinice za unutrašnju kontrolu i sa osobljem kompanije u vezi sa konkretnim akcionim i radnim planovima;
1.3 vodi lični radni dnevnik inspekcija u koji dokumentuje inspekcije, primedbe i preduzete radnje i vrši analitičku obradu podataka, o čemu izveštava Lidera na nedeljnom nivou;
1.4 Osigurava da su svi izvještaji i podaci predstavljeni u okviru njegove inspekcije tačni i u skladu sa stvarnom situacijom, što ću u slučaju spora tvrditi;
1.5 Po uputstvima šefa interne kontrole, obavlja radove i operativne poslove terenske kontrole, koji se odnose na obavljanje usluga kupcima, njihov kvalitet i protok;
1.6 Pregledava teren kamiona tokom transporta na sabirnim linijama;
1.7 U saradnji sa direktnim rukovodiocem, vrši inspekciju i prijavljuje moguće zloupotrebe prava na bolovanje i sve druge zloupotrebe;
1.8 vrši inspekciju poštovanja radnog vremena zaposlenih na terenu, a u slučaju zahteva i u administraciji;
1.9 Pregledati i proveriti broj praznina i njihovu tačnost;
1.10 Da odmah interveniše u slučajevima kada je dat konkretan nalog za akciju;
1.11 Obavlja druge poslove po nalogu direktnog vođe;
1.12 Za svoj rad odgovoran je šefu Jedinice za unutrašnju operativnu kontrolu.

**2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:**

- ✓ Budite državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poznaje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da obavlja relevantan zadatak;
- ✓ Ne biti osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

**3. Opšti formalni zahtevi**

- ✓ Obrazovanje Potrebno: Dodiplomski studij ili srednje obrazovanje
- ✓ Potrebno radno iskustvo: Najmanje 1 godina radnog iskustva

**4. Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja**

- ✓ Veštine logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske vještine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih profesionalnih presuda i diskrecije o pitanjima i značajnog doprinosa razvoju i implementaciji politike;
- ✓ Veliko znanje iz oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

**5. Dokumenti koji se podnose kao deo prijave i kako ih dostaviti**

| | |
|---|---|
| Zahtev za zapošljavanje i CV, popunjen i potpisan od strane kandidata | ✓ |
| Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova | ✓ |
| Kopije dokaza o zaposlenju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu) | ✓ |
| Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno) | ✓ |
| Kopije ouena rada za poslednje dve godine (poželjno) | ✓ |
| Identifikacioni dokument Republike Kosovo | ✓ |
| Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci | ✓ |

**6. Kako se prijaviti na konkurs i poslati prijavu:**

**6.1 Povlačenje zvaničnih obrazaca se vrši:**

* preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" A.D

* na recepciji kompanije.

**6.2 Podnošenje prijave:**

* Prijava za zapošljavanje, sa popunjenom dokumentacijom, podnosi se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i

* U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i u fizičkom obliku preko arhive kompanije.

**7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;**

Javni konkurs traje 15 dana od 04.05.2026. do 19.05.2026. godine.
Rok za prijem prijava je 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće biti razmatrane.

**8. Metod evaluacije i kriterijumi ocenjivanja.**

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prohodnost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

- ✓ Pismeni test: do 60 bodova
- ✓ CV kandidata: do 10 bodova
- ✓ Intervjuisanje: do 30 bodova.

**9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.**

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

**10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:**

Faza prethodne verifikacije prijava do 7 dana;
Pismena faza testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.
Objavljivanje rezultata vrši se do 3 dana nakon evaluacije intervjua.

**Napomena**: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji stignu nakon isteka roka za dostavu konkursa, neće biti pregledani.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ismajl Sadiki shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës sh.m.u.l. nga kl 6-9 në Mamush "Anadol" Mamush.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.

- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Albrim Syla shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 marsi" Prizren.

- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Zef Lush Marku" Velezhe.

- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfmu " Zef Lush Marku " Velezhe.

- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.

- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "FehmiAgani" Gjakovë me numër 200102037.

- Muharrem Miftari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Silvira Tomazini" gjimnazi "Frang Bardhi" Mitrovicë.

F2.2/BNJ/KP/RR

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 06/03/3736
Dt. 30.04.2026
Shtojcë
Prishtinë-Pristina

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A**

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe 12, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e datës 28.04.2026 me numër të protokollit 02/01/243 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

**KONKURS PUBLIK**

**Për plotësimin e vendit të punës**

| | |
|---|---|
| Titulli i Vendit të punës: | Koordinator për Shërbimin e Bizneseve në Njësinë Operative |
| Nr. i kërkuar: | Një (1) pozitë, Selia Qendrore në KRM "Pastrimi" SH.A |
| Numri i Referencës: | **KP/RR**/SQ/09-2026 |
| Koeficienti/Paga mujore: | Niveli VIII |
| Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: | Me kohë të pa caktuar |
| Periudha Provuese: | 3 muaj |

**1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1.1 Kujdeset për planin operativ të grumbullimit të mbeturinave tek bizneset,
1.2 Monitoron bizneset lidhur me llojin e mbeturinave,
1.3 Harton plane ditore, javore, mujore dhe vjetore per punën në njesi operative,
1.4 Shikon zbatimin e marrëveshjeve me biznese për mbeturina.
1.5 Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga mbikëqyrësi;
1.6 Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njësisë.

**2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:**

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

**3. Kërkesat e përgjithshme formale**

- ✓ Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare apo shkollim i mesëm
- ✓ Përvoja e punës e kërkuar: 1 vitë përvojë pune

**4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit**

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

**5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre**

| | |
|---|---|
| Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati | ✔ |
| Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore | ✔ |
| Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës) | ✔ |
| Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme) | ✔ |
| Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme) | ✔ |
| Dokument identifikimi e Republikës së Kosovës | ✔ |
| Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj | ✔ |

**6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:**

**6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:**

* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.
* në recepcionin e kompanisë.

**6.2 Dorëzimi i aplikacionit:**

* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

**7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:**

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 04/05/2026 deri me datën 19/05/2026.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

**8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.**

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ Testit me shkrim: deri në 60 pikë
- ✓ CV-ja e kandidatit: deri në 10 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 30 pikë.

**9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.**

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

**10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:**

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

**Vërejtje**: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.






F2.2/BNJ/KP/RR

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 06/03/3736
Dt. 30.09.2026
Shtojcë
Prishtinë-Pristina

**REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D**

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, posebno člana 8, na osnovu Uredbe br. 07/2024 o radnom odnosu u CRM "PASTRIMI" a.d., konkretno člana 11. stav 1.2 i 12, na osnovu Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" A.D, na osnovu Odluke od 28.04.2026. godine sa brojem protokola 02/01/243 izvršnog direktora RPO-a "PASTRIMI" A.D, objavite ovo:

**JAVNI KONKURS**
**Za popunjavanje radnog mesta**

| | |
|---|---|
| Naziv radnog mesta: | Koordinator poslovnih usluga u operativnoj jedinici |
| Br. Potreban: | Jedno (1) radno mesto, Sedište u KRM "PASTRIMI" A.D |
| Referentni broj: | **KP / RR** / SK / 09-2026 |
| Koeficijenti/Mesečna plata: | Nivo VIII |
| Trajanje ugovora o radu: | Na neodređeno vreme |
| Probni period: | 3 meseca |

**1. Dužnosti i odgovornosti:**

1.1 brine o operativnom planu prikupljanja otpada u preduzećima,
1.2 Prati preduzeća u pogledu vrste otpada,
1.3 izrađuje dnevne, nedeljne, mesečne i godišnje planove rada u operativnoj jedinici,
1.4 Gleda na sprovođenje sporazuma sa preduzećima za otpad.
1.5 obavlja poslove i druge poslove koji se odnose na opis radnih zadataka, koje zahteva supervizor;
1.6 On je odgovoran menadžeru jedinice za svoj rad.

**2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:**

- ✓ Budite državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poznaje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da obavlja relevantan zadatak;
- ✓ Ne biti osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

**3. Opšti formalni zahtevi**

- ✓ Obrazovanje Potrebno: Dodiplomski studij ili srednje obrazovanje
- ✓ Potrebno radno iskustvo: 1 godina radnog iskustva

**4. Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja**

- ✓ Veštine logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske vještine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih profesionalnih presuda i diskrecije o pitanjima i značajnog doprinosa razvoju i implementaciji politike;
- ✓ Veliko znanje iz oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

**5. Dokumenti koji se podnose kao deo prijave i kako ih dostaviti**

| | |
|---|---|
| Zahtev za zapošljavanje i CV, popunjen i potpisan od strane kandidata | ✔ |
| Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova | ✔ |
| Kopije dokaza o zaposlenju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu) | ✔ |
| Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno) | ✔ |
| Kopije ouena rada za poslednje dve godine (poželjno) | ✔ |
| Identifikacioni dokument Republike Kosovo | ✔ |
| Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci | ✔ |

**6. Kako se prijaviti na konkurs i poslati prijavu:**

**6.1 Povlačenje zvaničnih obrazaca se vrši:**

* preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" A.D
* na recepciji kompanije.

**6.2 Podnošenje prijave:**

* Prijava za zapošljavanje, sa popunjenom dokumentacijom, podnosi se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i
* U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i u fizičkom obliku preko arhive kompanije.

**7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;**

Javni konkurs traje 15 dana od 04.05.2026. do 19.05.2026. godine.
Rok za prijem prijava je 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće biti razmatrane.

**8. Metod evaluacije i kriterijumi ocenjivanja.**

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prohodnost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

- ✓ Pismeni test: do 60 bodova
- ✓ CV kandidata: do 10 bodova
- ✓ Intervjuisanje: do 30 bodova.

**9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.**

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

**10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:**

Faza prethodne verifikacije prijava do 7 dana;
Pismena faza testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.
Objavljivanje rezultata vrši se do 3 dana nakon evaluacije intervjua.

**Napomena**: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji stignu nakon isteka roka za dostavu konkursa, neće biti pregledani.




100% Fresh & Natural
VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME FINESË DHE DASHURI
2,8%
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES
95 g